



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA PATOS**  
KËSHILLI I BASHKISË  
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 3658/4 Prot.

Patos, më 15/11 / 2024

**PROCESVERBALI I TAKIMIT 14 NËNTOR 2024**

**Vendi:** "Njësia administrative Zharrëz"

**Ora e fillimit:** 10:00

**Ora e mbarimit:** 12:00

**Dëgjese publike me temë: "Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027"**

**Baza Ligjore:** Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025".

**Pjesëmarrës:** Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Drejtore e Financave znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj, Drejtore e Planifikimit Urban znj. Boreta Murati, Drejtor i Zhvillimit Bujqësor z. Orges Golloshi, Drejtore e Projekteve znj. Ermenita Mici, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, rreth 27 pjesëmarrës (banorë, kryetarë të fshatrave dhe përfaqësues të subjekteve që operojnë në njësinë Zharrëz).

**Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj**

**Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj**- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025”. Do t’ju lutesha që si gjithmonë të respektojme rregullat e dëgjesës, gjithsecili para se të kërkoj



**Kryetari i Këshillit  
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

fjalën duhet të prezantohet me emër, mbiemër në mënyrë që çdo ankesë, propozim apo mendim i juaj të trajtohet në bazë të ligjeve në fuqi. Edhe njëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen. Dëgjesën e deklaroj të hapur dhe ja kaloj fjalën administratës për të bërë prezantimin e materialit.

**Drejtoresha e financave znj. Mimoza Shtëmbari**– përhëndetje të gjithëve! Ne sot do të bëjmë prezantimin e paketës përfundimtare të buxhetit për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027. Përpara



**Drejtoresha e financave  
znj. Mimoza Shtëmbari**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

se të arrinim në momentin përfundimtar të hartimit të dokumentit ne kemi bërë disa takime në të



cilat kemi mbledhur priritetet e qytetarëve dhe të të interesarve dhe më pas kemi arritur në hartimin e dokumentit përfundimtar. Në këtë buxhet kemi një rritje të të ardhurave me 5% nga të ardhurat dhe një rritje me 11% nga transfertat e pakushtëzuara që përbëjnë burimet kryesore të buxhetit për vitin 2025. Nga adresimi i problemeve tuaja dhe nga dëgjuesat publike kanë qenë rikonstruksioni i rrugëve të brendshme, vendosja e ndriçimit, rregullimi i varrezave dhe problematika të ujësjellësit të cilat ne i kemi adresuar në ndërmarrjen përkatëse për ndërhyrje. Për sa përket pjesës së ndërhyrjeve që përmenda më sipër, pra që bashkia i mbulon janë adresuar dhe ndërhyrjet kanë filluar që në vitin 2024 dhe do të jenë në vazhdim edhe në vitin 2025. Për pjesën e investimeve dhe mirëmbajtjes së ndriçimit të rrugëve do të shpjegojnë edhe drejtoret përkatëse me detaje.

**Drejtores e Planifikimit Urban znj. Boreta Murati**- përshëndetje! Unë do të shpjegoj pjesën e mirëmbajtjes fillimisht ku kemi parashikuar që në vitin 2025 të ndërhyjmë në rrethimin e varrezave në Zharrëz dhe Frashër. Gjithashtu do të ndërtohen dy ministacione për sistemin e vaditjes në fshatin Sheqishte, rikonstruksioni i banesave të famijeve në nevojë në fshatin Sheqishte dhe Belinë. Do të bëhet edhe rikualifikimi i sheshit të kopshti në Belinë dhe do të vendosen sinjalistika rrugore dhe kjo do të jetë sipas kërkesave të banorëve për secilin fshat. Ndriçimi në segmentet e asfaltuara që janë asfaltuar në vitin 2023 dhe 2024 dhe segmente të cilat janë në errësirë dhe do bëhet ndriçimi në vijim në vitin e ardhshëm. Gjithashtu të parashikuar kemi shtrimin e rrugëve me asfalto beton në Zharrëz siç janë rruga “Grëmballarët”, rruga “Doganëve”, rruga “Mjerakët”, rruga “Bani dhe Kiklat”, rruga “Bahaj”. Në Fshatin e Ri janë rruga “Pëllumbaj”, “Ngjeliu”, “Demollarët”, segmenti 8-Dhjetori, në Vebas rruga Prendajt, segment parcela 88 (Zdrukhtaria) dhe rruga Pusi.



**Drejtores e Planifikimit Urban  
znj. Boreta Murati**

**Dëgjuesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

Një nga rikonstruksionet që do të bëhet së fundmi është në fshatin Belinë në rrugën “Rilindja”, e cila 200 m ose 100 m përpara urës në Sheqishte dhe 1 km vazhdon pas urës që është ai segmenti i dëmtuar dhe është problem për gjithë banorët që jetojnë në fshatin e Belinës. Një nga investimet që do të bëhet nga Ministria e Arsimit për vitin e ardhshëm është rikonstruksioni i shkollës “Sotir Çapo” dhe mirëmbajtja e vazhdueshme që do të bëhen për të gjitha institucionet e tjera arsimore në të gjithë njësinë administrative Zharrëz. Do të bëhet edhe një investim nga Bankers që është rruga Fshati i Ri dhe Frashër anës Përroit. Faleminderit!

**Drejtor i Zhvillimit Bujqësor z. Orges Golloshi** – përdhëndetje! Parashikimet që janë bërë në programin e bujqësisë këtu në Zharrëz kemi menduar shtimin e investimeve në shtrimin e parcelave me çakull ku planifikohen një pjesë kryesore dhe e konsiderueshme në Zharrëz. Rrugë parcelash të cilat do mirëmbahen vetëm me mjete në dispozicion nga bashkia planifikohen mbi 10 mijë metër linear. Kemi ndërtimin e stacionit të Belinës të ujitjes, i cili në sezonin e ardhshëm do të jetë gati. Dy ministacione ujitjeje planifikohen edhe në Sheqishte që mbulojnë rreth 200



**Drejtor i Zhvillimit Bujqësor  
z. Orges Golloshi**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

hektar tokë bujqësore me ujitje. Gjithashtu është planifikuar të aplikohet edhe për digën e rezervuarit të Zharrëzës dhe mirëmbajtjen e saj në funksionimin e sarqineskës në mënyrë që të mbulohen të gjitha tokat e Zharrëzës dhe Verbasit me vaditje nga ky rezervuar. Janë planifikuar gjithashtu rrugët ku do të ndërhyet dhe pemët dekorative rreth 150 pemë, të cilat i kemi dhuratë nga Bankers. Brenda dhjetorit përfundon blerja dhe do filloj rehabilitimi i rreth 2 mijë metër linear të rrugëve të parcelave në Frashër ku bëhet fjalë për rrugën kryesore që del te zona e burgut në rrugë kryesore dhe te parcela numër 5. Për sa i përket mirëmbajtjeve të zakonshme që ne bëjmë me mjetet tona kemi planifikuar 19 mijë metër linear në ndërhyrje në pastrimin e kanaleve kulluese dhe vaditës. Këto janë zërat kryesor në shërbimet në fushën e bujqësisë dhe të ujitjes e kullimit. Faleminderit!



**Drejtores e Projekteve dhe Emergjencave Civile znj. Ermenita Mici-** përshëndetje të gjithëve!  
Nag drejtores e projekteve po hartohet projekti për segmentin e rrugës “Rilindja” te ura në Belinë që është segmenti që është plasaritur dhe jemi në pritje të përgjigjes nëse do ta vazhdojmë këtë aplikim apo jo.



**Drejtores e Projekteve dhe  
Emergjencave Civile  
znj. Ermenita Mici**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Anëtarë i Këshillit Bashkiak z. Erald Çepele-** përshëndetje! Dua të them edhe unë disa fjalë si pjesë e këshillit. Në Zharrëz janë parashikuar shumë rrugë për t’u mbyllur me asfalto beton. Pjesa më e madhe e tyre gati 90% do të mbyllen brenda 2025. Ky është edhe buxheti i parë i mirëfilltë le të themi që do të ketë shumë ndërhyrje dhe punë lidhu me njësinë. Sot në Patos psh. Jamë bërë mbi 15 sheshe. Edhe Zharrëzës do i vij dita për rehabilitimin e shesheve. Dua të theksoj edhe diçka tjetër. Ne, çdo fundviti si këshill bëjmë një rialokim fondesh ku tepricat i vendosim në projekte të tjerë me anë të të cilave mund të bëjmë ndërhyrje që ka nevojë vendi sipas prioriteteve. Do të vendosen edhe panlet diellore në vazhdim.



**Anëtarë i Këshillit Bashkiak  
z. Erald Çepele**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj-** me prezantimin e materialit ekzekutivi mbaroi kështu që mund të vazhdoni me pyetjet dhe ju lutem respektoni rregullat e dëgjësës.



**Kryetari i Këshillit  
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjësë publike me temë:  
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Kryetar i fshatit Verbas z. Bilbil Çepele-** përhëndetje! Kisha një pyetje lidhur me rrugët që ju përmendët me emra. Ku janë këto rrugë sepse asnjë nga ata nuk kanë tabela dhe nuk i identifikojmë dot? Ne kemi edhe rrugë andej nga serat që nuk kalon dot dhe duhen asfaltuar që të kalojmë.



**Kryetar i fshatit Verbas  
z. Bilbil Çepele**

**Dëgjësë publike me temë:  
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Anëtarë i Këshillit z. Erald Çepele-** edhe në një mbledhje tjetër është ngritur problemi i tabelave të rrugëve dhe është thënë që pothuajse rrugët kanë emra dhe kanë vite që janë miratuar, mirëpo tabelat e atyre që janë hequr do të vendosen përsëri që të gjitha në mënyrë që ju të arrini të identifikoni rrugët.





**Anëtarë i Këshillit  
z. Erald Çepele**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Drejtores e Planifikimit Urban znj. Boreta Murati** – një pjesë e rrugëve kanë emërtime dhe ndoshta një pjesë e tyre që kanë degëzime marrin emrin e rrugës kryesore, ndërsa një pjesë të tyre e emërtojmë sipas emërtimeve të fiseve. Dhe emrat e rrugëve vendosen sipas kërkesave tuaja gjithmonë.



**Drejtores e Planifikimit Urban  
znj. Boreta Murati**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Drejtores e financave znj. Mimoza Shtëmbari**- pjesa që u prezantua sot do të marr jetë



**Drejtores e financave  
znj. Mimoza Shtëmbari**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

menjëherë kur të filloj zbatimimi i buxhetit, por datë fikse nuk ju themi dot sepse çdo buxhet ka fazat e veta.

**Banor i njësisë Zharrëz z. Agur Ferra**- unë kam një problem shumë serioz. Nuk kam rrugë të shtëpia dhe nuk futem dot në shtëpinë time. Hajdeni tani ta verifikojmë bashkë dhe shikojeni që nuk hyj dot në shtëpinë time.



**Banor i njësisë Zharrëz  
z. Agur Ferra**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Drejtoresha e Planifikimit Urban znj. Boreta Murati** – ajo rrugë është parashikuar megjithatë në do të vijmë dhe do ta verifikojmë në vend këtë problem dhe do mundohemi t’i japim zgjidhje.



**Drejtoresha e Planifikimit Urban  
znj. Boreta Murati**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Banor i fshatit Sheqishtë z. Flamur Grëmbi** – kam një pyetje. Do të shtrohet rruga anës Përroit që është mbulluar me ferra?





**Banor i fshatit Sheqishte  
z. Flamur Grëmbi**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Drejtoresha e Planifikimit Urban znj. Boreta Murati** – segmenti i cili fillon nga fundi i Frashërit, anës Përroit e gjithë do të bëhet nga Bankersi sepse është pjesë e marrëveshjes.



**Drejtoresha e Planifikimit Urban  
znj. Boreta Murati**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Anëtarë i pleqësisë Zharrëz z. Bajram Hazizaj** – unë kam ngritur edhe herën e kaluar një problem për rrugën e Zabias, por nuk dëgjova në prezantim që është parashikuar diçka lidhur me këtë rrugë. Të paktën të bëhet ndonjë ndërhyrje e vogël të mund të kalojmë ne fermerët.



**Anëtarë i pleqësisë Zharrëz  
z. Bajram Hazizaj**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Administrator i njësisë administrative Zharrëz z. Riza Hoxha-** kjo rrugë është verifikuar në terren me drejtorin e bujqësisë dhe përveç shtrimit është planifikuar edhe shtrimi i një tumbino aty.



**Administrator i njësisë administrative  
Zharrëz  
z. Riza Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Banor i Zharrëzës z. Xhimi Grëmbi-** unë kam një problem sepse kam mbjell perimet dhe nuk kaloj dot nuk kam rrugë. Është edhe problemi i pusit të naftës që u premtua që do të pastrohej nga mbeturinat dhe nuk është pastruar.



**Banor i Zharrëzës  
z. Xhimi Grëmbi**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**



**Administrator i njësisë administrative Zharrëz z. Riza Hoxha-** për pjesën e rrugës unë kam biseduar me drejtorin sepse u bë një investim nga ujësjellsi lidhur me tubacionin e ujërave të zeza dhe do kthehet në gjendjen e mëparshme. Ajo si rrugë është e planifikuar për t'u bërë me asfalto beton. Megjithatë ne kemi biseduar dhe kemi premtuar që këto ditë do të hidhet çakull në rrugë.



**Administrator i njësisë administrative  
Zharrëz  
z. Riza Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Banor i njësisë Zharrëz z. Enver Hasani-** unë kam një pyetje lidhur me këtë firmën e ujësjellsit. Si e ka orientimin sepse po ikin vetëm drejt dhe disa zona nuk po ndërhyjmë për vendosjen e tubacioneve për ujërat e pijshëm. Edhe te varrezat e Zharrëzës ka qenë problematik dhe unë e kam paraqitur këtë rast. Edhe për pjesën e objekteve të vjetra që rrezikojnë jetët e njerëzve çfarë mase do merren? Te liqeni i Zharrëzës është mbushur komplet me mbeturina dhe ne nuk vadisim më me atë ujë. Më mirë ta studioni atë zonë përpara se të ndërhyni.




**Banor i njësisë Zharrëz  
z. Enver Hasani**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Drejtoresha e Planifikimit Urban znj. Boreta Murati**- lidhur me ujësjellsin fillimisht po punohen linjat kryesore dhe më pas do të shtrihet në të gjitha zonat sipas projektit që ata kanë. Pasi të përfundojë shtrimi i linjave kryesore bashkë me drejtorinë e ujësjellsit të Fierit do vazhdojë



**Drejtoresha e Planifikimit Urban  
znj. Boreta Murati**

**Dëgjese publike me teme:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

degëzimi i linjave për çdo familje që ka ngelur pa trajtuar. Këto probleme adresojani Rizait, administratorit të njësisë në mënyrë që të mund të ndërhyjmë për plotësimin e kërkesave tuaja. Për pjesën e ndërtesës vjetër është diskutuar me agjencinë dhe do të ndërhyjmë për të rregulluar situatën.

**Kryetari i Fshatit të Ri z. Bexhet Rredhi** –për emergjencat civile ne kemi bërë një listë me bujqësinë për plastmaset që dëmtuan nga zjarret herën e fundit. A do të përfitojmë ndonjë ndihmë për këto ne?



**Kryetari i Fshatit të Ri  
z. Bexhet Rredhi**


**Dëgjese publike me teme:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**



**Drejtor i Zhvillimit Bujqësor z. Orges Gollosi**– problemin e plastmaseve e kemi ndjekur me Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe nuk është objekt i bashkisë Patos sepse nuk ka një ligj që të dëmshpërblej fermeret për shkak të fatkeqësive natyrore. Kjo është kompetencë e institucioneve qendrore. Për pjesën e zjarreve në tokat bujqësore janë bërë të gjitha verifikimet nga ana e



**Drejtor i Zhvillimit Bujqësor**

**z. Orges Gollosi**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

bashkisë, janë marrë fermerët me sipërfaqe se sa janë dëmtuar dhe janë bërë përjashtimi nga taksa e tokës bujqësore në masën 75% për një afat 5 vjeçar.

**Banor i njësisë Zharrëz z. Agur Ferra**– Një problem tjetër lidhet me rrugën “Mjerakët” që nuk u përmend fare dhe gjithashtu edhe ura te Gjerbacakët është një problem serioz ku kanë rënë 4 veta dhe duhet të merren masa.



**Banor i njësisë Zharrëz**

**z. Agur Ferra**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Drejtoresha e Planifikimit Urban znj. Boreta Murati**- do ta verifikojmë dhe do marrim masa lidhur me këtë çështje.



**Drejtoresh e Planifikimit Urban  
znj. Boreta Murati**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar  
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj-** Unë ju falenderoj për kontributin e dhënë dhe do dëgjohe mi në takime të tjera. Edhe një herë faleminderit!



**Kryetar i Këshillit**

**z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për  
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

**Nëntor 2024**

**Koordinator i Konsultimit Publik**

Simela Shahinaj

**Sekretar i Këshillit**

Refaela Xeba











